



Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Nr. 57

Datë: 30. 10. 2017, ora: 10:00

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesues i mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ-së

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Ilir Gashi, Sami Hamiti, Adnan Rrustemi, Binak Vishaj, Eshref Vishi, Stevan Veselinoviq, Ercan Spat, Bajram Ljatifi, Ergit Qeli

SKQZ: Enis Halimi, Kryeshef i SKQZ

Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPP; Përkthyesë: Vera Dula

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;

- *Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të KQZ-së nr.56 /2017;*

2. Raport i Këshillave të KQZ-së ;

-Këshilli për Buxhet dh Financa;

- *Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për transferim të mjeteve;*

- *Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të nënujorit të shpenzimeve të KQZ-së;*

- *Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit nëntëmujor i pasqyrave financiare;*

- *Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të buxhetit të KQZ-së për vitet 2018 deri 2020;*

3. Të ndryshme;

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;

Valdete Daka: Mirë se keni ardhur në mbledhjen e 57 të KQZ-së. A ka dikush vërejtje në rend dite? Ndoshta veç kishte me qenë mirë me marr informata për QNR-në nga kryeshefi.

Ercan Spat: Unë në kohën kur janë zgjedhjet edhe një orë para takimit, m'u thirr mbledhja m'u duk normale, u ngutëm dhe erdhëm me kohë. Por, po shikoj rendin e ditës: kjo nuk ka lidhje me procesin e zgjedhjeve. Për këtë rend dite, ka qenë e mundur me na informuar më herët me përgatit materialin me na dërguar, sepse materiali është shqyrtuar javën e kaluar në këshill. E kam si pyetje, jo si propozim për rend dite.

Valdete Daka: Atëherë nëse nuk kemi diçka tjetër për rend dite. Kush është për këtë rend dite?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të KQZ-së nr.56 /2017

Valdete Daka: Sa i përket procesverbalit, a ka dikush vërejtje. Nëse jo atëherë kush është për?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan procesverbalin e KQZ-së nr.56 /2017

2. Raport i Këshillave të KQZ-së

Këshilli për Buxhet dh Financa

1. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për transferim të mjeteve

Ilir Gashi: Përshëndetje për të gjithë. Ne, i kemi mbajtur javën e kaluar në Këshillin për buxhet, në fakt të premtën katër pikat që janë këtu. Janë: "Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për transferim të mjeteve", "Shqyrtimi dhe miratimi i raportit 9 mujor të shpenzimeve", "Shqyrtimi dhe miratimi 9 mujor i pasqyres financiare". Mirëpo, në mungesë të kuorumit ashtu erdh situata në këshill, pra nuk patëm kuorum dhe pikën "Shqyrtimi dhe miratimi i planit të buxhetit të KQZ-së për vitet 2018 deri 2020", ka mbetur me ardhur drejtpërdrejt në KQZ. Për këtë arsye, edhe kemi bërë përpjekje që me ardhë të premtën t'ju shpërndahet të gjithëve anëtarëve, dhe të trajtohet për qa sa ka mundësi me u trajtuar dhe pastaj, këtu të vendosim për të. Unë, po shkoj me rradhë. Në fakt, e kemi trajtuar shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për transferove të mjeteve. Ky transfer, kërkohet të bëhet në programin e Sekretariatit (14100) në bazë të vendimit të KQZ-së nr 403/2017 të datës 28.04.2017. Në këshill, tha z. Gashi, e kemi miratuar pagesën e antarsisë së Asosacionit të Trupave Zgjedhore AËEB në vlerë prej 10 000 euro. E kemi trajtuar në baz të arsytimit që i ka dhanë nga Sekretariati.. E kemi miratuar këtë transferë për arsye se është i domosdoshme, si dhe programin e zgjedhjeve në kategorin e udhëtimeve zyrtare. KQZ ka marrë vendim dhe ka caktuar zyrtar për vëzhgimin e Fletë votimeve për roundin e 2-të të zgjedhjeve lokale 2017, andaj kërkohet transferi prej shumës prej 2000 euro. Pas analizes së bugjetit vlerësuese

ZRE13.330 të shpenzimeve postare, konstatojmë se ka mjete të cilat mundë të transferohen, andaj ne si këshill e kemi miratuar këtë transfer.

Valdete Daka: Atëherë, Kush është për rekomandimin e Këshillit për buxhet që të miratohet...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të nënujorit të shpenzimeve të KQZ-së

Ilir Gashi: Atëherë, duhet me u shqyrtue dhe me u miratuar edhe raporti 9 mujor i shpenzimebe të KQZ-së. Janë shpenzuar 8 milion e 356 mijë e 776.49 euro, përkatësisht bugjeti i planifikuar i shpenzuar është, 57.7%: rroga dhe medijtje jan shpenzuar për 9 muaj më shumë se 726.254 euro, ose 70.5%. mallra dhe shërbime janë shpenzuar për 9 muaj 4 milion 480.695 euro, ose 49.3%, shpenzime komunale nga bugjeti janë shpenzuar për 9 muaj 26.132 euro, ose 34.1%, subvencione dhe transfere nga bugjeti janë shpenzuar për 9 muaj 3 milion e 90. 915 euro ose, 73.8%. Ky është faktikisht raporti i 9 mujor i shpenzimeve të KQZ. Ne rekomandojmë të miratohet...

Valdete Daka: A ka dikush ndonjë pyetje, ndonjë vërejtje lidhur me këtë raport...?

Sami Hamiti: Në përgjethsi, trendi i shpenzimeve është në rregull, s'ka diqka por, prapë i kemi mallrat dhe shërbimet që e kan në formë për shkak të pagesave që i kemi përdorë, dhe në shpenzime kapitale...Mos po na shtini prapë në fundë të vitit që me marrë obligime për vitin e ardhshëm...Mos bëni kontrata tash e tutje të cilat nuk mundë t'i realizoni...Po futemi në nëntor me 225 mijë euro...Me i shpenzue është ne rregull, po me na shti në obligime e me ba kontratë, e me ardhë në vitin e ardhshëm, mos e bëni të njejtën gjë që e kemi pasur në vitin e kaluar...Në pjesën tjetër, është në mnyrë lineare shpenzi që s'janë shuma të mëdha, nuk qojnë shumë peshë...Në mallra edhe shërbime, e di që ju vijnë pagesat, në fundë edhe mund të permisohen...Aty, investimet kapitale mos hyni në kontrata në fund të vitit e me mbetë pa u realizue...Ky është sugjerimi im...

Enis Halimi: Shumë me vende, por ne e kemi rishikuar nga krijimi i bugjetit, është një çështje që të gjith e dimë, por dy projekte i kemi larguar nga plani i punës që kan reflektuar për shkak se ka ndodh rishikimi...Ndërkaq, këto projekte kapitale kanë qenë tjera: rregullimi i ueb faqes me vlerë 7000 euro...! Është duke u kryer si proces, e tash i kemi edhe dy projekte që janë duke u realizuar për Qendren e Numërimit, është skanimi i formularit si pilot projekt...

Miradie Meha, drejtoresh e DAP-it: Janë planifikuar 225 mijë e 800 euro për 6 programe: 3 programe kanë qenë të zhvilluara, dhe 3 të tjera në programin e zgjedhjeve. Prej këtyre 6 projekteve, kur është bërë rishikimi i bugjetit, në pamundësi që të realizohet ky projekti, është bërë rishqyrtimi i këti projekti të cilin e ka aprovuar KQZ...Ka qenë vlera edhe aplikacioni online përmes postes në vlerë prej 60 mijë euro, projekti tjetër ka qenë në vlerë prej 30 mijë euro...Dhe, këto dy projekte njëra ka shku për blerjen e veturave e cilat, nuk janë realizu për arsye të rishikimit dhe, është e pa mundur për me u realizue

sepse, koha është shumë e shkurtër. Për projektin tjetër në sistemin e menagjimit të informatave që ju ka ndërru distini, është realizuar vetëm një projekt loto me vlerë 24 mijë 779 euro. Loto e dytë, është e nënshkrime por, ajo ende s'ka përfunduar. Procesi i realizimit të kësaj kontrate në vazhdimsi, është projekti i skanimit të formularëve të rezultateve që janë në vlerë prej 65 mijë euro. Për këto, vetëm që është nënshkruar kontrata, si dhe regjistrimi edhe evidentimi i materialit zgjedhorë është në vlerë prej 30 mijë euro. Sikurse që tha edhe Kryeshefi, edhe menaxhimi i ueb faqës së KQZ me vlerë prej 7 mijë euro...Për këto 4 projekte, janë të nënshkrime kontratat. Njëra prej tyre është realizuar pjesërisht, dhe është paguar në 7 mujorin e parë, të tjerat në 3 mujt e fundit...

Sami Hamiti: Ne po flasim për programin e zgjedhjeve të programi i Sekretariatit, qysh e keni rezultatin të mallrat edhe shërbimet dhe po ashtu, të investimet. Në të dyjat jeni keq...Këto i keni me të shpenzuar, ama këto s'keni m'i shpenzuar...s'ka lidhje që jemi në zgjedhje...Çka keni ba me 351 mijë...? Edhe të shpenzimet kapitale, po ashtu, i keni edhe 65%, po flas për Sekretariatit...Ju, tani jeni ju përgjegjës...

Miradie Meha: Te shpenzimet e Sekretariatit në mallra dhe shërbime, janë shpenzuar vetëm 46.3%, të kapitalet, janë shpenzuar 35%...Kjo është vlera reale bazë gjendjes, plus nuk ka ardhë vlera e këti projekti që ka qenë 30 mijë euro, ka ardhë në 38.800 euro, n'i loto ka ardhë 24 mijë euro, loto tjetër është 4 mijë e diçka euro...Këto janë për paisje teknologjike informative që janë të Sekretariatit...

Sami Hamiti: Shikoni, keni ende kohë me të kontrolluar dhe me të shpenzuar...!

Valdete Daka: Diçka tjetër a kemi...? Si qëndron puna, se...!

Miradie Meha: Këtu nuk ka bartje, pasqyrat financiare janë në afat deri më 31 tetor, deri nesër...

Sami Hamiti: Gjithë ne i marrim këto, po na i keni sjellë në ditën e fundit të punës dhe për me të votuar...po, jemi në në situatë nuk kemi qare se tash...! Pra, edhe një herë po e perserisë se raport financiar ne mund të kërkojmë për 6 mujor, dhe jo për 9 mujor, mundemi me kërkuar edhe raport njëmuja dhe nuk kemi qare pa e sjellë...Se, po doni me të mbuluar..., po dështoni me 6 mujor, po nuk ka problem por, nuk është korrekte...Kjo është qesharake...! Po ju them nuk është në rregull, nuk është në rregull...Po ju bani çka të doni...E kemi një raport pune që me e krahasuar se çka keni planifikuar se çka keni shpenzuar, deri kur kemi mbërritur...! Nuk e di çka mundemi me thanë...Me pas vepruar siç kam thanë, siç e do rendi tash nuk e kishim diskutuar fare këtë punë... E përsëritë një dhjetë herë...Unë kam vëretje..., mos e bani veten që s'dini se janë standardet si bahen k'to punë...Mos të hi në detale si i keni ba...! Atje, hiqeni Flamur Plakiqin se nuk e kemi m'a, keni edhe copy paste...

Valdete Daka: E kemi raportin e shpenzimeve të KQZ-së për 9 muj. Kush është për miratimin e këtij raporti?

Anëtarët e KQZ-së, pas shqyrtimit miratuan rekomandimin e Këshillit për Buxhet të shpenzimeve nëntëmuja të KQZ-së

3.Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit nëntëmuor i pasqyrave financiare

Ilir Gashi: Po, në këshill e kemi trajtuarkëtë raport dhe ne rekomandojmë që të miratohet në KQZ. Pasqyrat janë përgaditur në bazë të obligimeve normal të cilat dalin nga ligjet e financave publike dhe ligjit nr. 03/048, në bazë të rregulles 06/2011 të raportimit të 9 muor të organizatave dhe bugjetore që është si obligim dhe, i rekomandohet KQZ –së që të miratohet.

Valdete Daka: Unë, e pata vetëm një pyetje: Te ky raport, te këto obligime, kontingjente dhe detyrime sipas pretendimeve të raporteve ekonomike janë në vlerë prej 259.659 euro...Dhe në tabelë e paraqitur me të dhëna sipas natyrës..Tash, unë këto nuk i kuptova: A janë që na duhet me i krye këto obligime apo, janë vetëm kërkesa...? Për momentin, këto janë procedura gjygsore, dhe këto rekomandime të auditorit të përgjithshem të viti 2016, këto për planin e zbatimit por, askush s’na ka treguar se çka ka ndodh me planin e zbatimit...Nuk po e shoh: A jon zbatuar këto, a jo...? Tash, na vjen raporti tjetër e ne ende s’po dimë se çka ka ndodh me raportin e vitti 2016 ! Tash, unë për veti, për shembull..pa e ditë mirë këtë unë nuk e votoj...Se, nuk po e di se çka ka ndodhë, veç na e keni pru...por, unë nuk e di se çka ka ndodhë me këto raporte dhe rekomandime...Unë, kam me shkue prapë e me raportue, dhe prapë kan me më pyetur se a janë zbatuar rekomandimet, çka ka ndodh, a janë realizuar rekomandimet...

Enis Halimi: Kryetare, kjo është një formë standarde...! Instutacioni ynë ka specifika që, shumica e tyre se ç’ka kërkohet në raport, janë 00.00. Nuk gjenerojnë të hyra, e as nuk i kemi specifikat e instutacioneve qeveritare ekzekutive që i ka janë të tjerat...Për këtë arsye, ky raport shkon kështu me këtë plani të zbatimit të rekomandimeve që e ka si ankes...S’i raport, ne mundemi me e heqë po, është si strukturë e raportit dhe, si i tillë duhet me shkue...

Valdete Daka: Atëherë, kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rekomandimin e Këshillit për Buxhet.

Valdete Daka: Vazhdojmë me pikën e rradhës: Shqyrtimi i miratimit të plainit të bugjetit të KQZ-ës për vitin 2018 deri 2020.

4.Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të buxhetit te KQZ-së për vitet 2018 deri 2020

Ilir Gashi: Kërkesat bugjetore të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për 2018, janë në bazë përgjegjësie që dalin nga ligji i menagjimit të financave publike dhe përgjegjësitet dhe udhëzimet që janë dhënë gjatë kohës bugjetore 2018 01, 2018 02 të shquar nga ministria e financave. KQZ, ka përgatitur buxhetin 2018-2020 sipas vlerave... Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka hartu bugjetin edhe për 3 vitet e ardhshme gjegjësisht për vitin 2018 është bërë planifikim ndërsa për dy vitet në vazhdim janë bërë vlerësimet bugjetore, pagat dhe mëditjet është planifikuar për 93 zyrtar të KQZ-ës në bazë të strukturës së re

organizative të KQZ-ës përkatësht rregullores 02 2017 dhe të nivelizimit të pagave me institucionet tjera të pavarura të Republikës së Kosovës. Mallrat dhe shërbimet të cilët kanë të bëjnë me buxhetin e shpenzimeve operacionale dhe shpenzimet tjera operative të institucionit të KQZ-ës si dhe me disa projekte tjera të cilat i përkrahin përgatitjet dhe avancimet e proceseve zgjedhore, shpenzimet kapitale janë planifikuar projekte të cilat kanë të bëjnë me furnizimin dhe blerjen për nevojat e KQZ-ës, shpenzimet komunale janë në pajtim me kufit buxjetor të lëshuar me qarkoren buxjetore 2018 02, subvencionet transferet kanë të bëjnë me përkrahjen e subjekteve politike në përputhje me qarkoren buxjetore 2018 02. Buxheti për 2018 me gjithë atë pas lëshimit të kufive buxjetor 2018 02 dhe njëerë, është analizuar buxheti i planifikuar sipas programit dhe është bërë krahasim mes buxhetit të planifikuar dhe kufive buxjetor nga kjo rrjedh se kërkesat buxjetore të KQZ-ës në disa kategori janë të larta se ato të dhënat në këta kufi. Në total kërkesat buxjetore të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve janë më të larta për vitin 2018 se sa kufit e dhënë, buxheti i KQZ-ës për këtë vitë është 684793 ndërsa buxheti sipas kufive në total është 5594092 euro pra, kërkesat buxjetore të KQZ-ës janë më të larta për 8.7% apo për 490 mijë e 701 euro. Sipas kategorive ekonomike kërkesat buxjetore janë më të larta në paga dhe mëditje për 410 mijë e 180 euro dhe mallra dhe shërbime 80 mijë e 521 euro. Subvencionet dhe transferet janë në vlerë të njëjta me kufit buxjetor e 2018 02, keni edhe tabelën e bashkangjitur për detaje tjera besoj që edhe kryeshefi dhe drejtoresh atë ju njoftojnë. Faleminderit.

Valdete Daka: A ka dikush pyetje...?

Sami Hamiti: Po e shoh se planifikimi dhe qarkorja ka diskrecion apanca edhe pjesa e përlogarotjes së pagave, ne e kemi vendos një rregullore edhe e kemi votu me ata koeficient. Insistimi duhet të jetë që të përmuset edhe ajo pjesë, përndryshe mallrat edhe shërbimet 80 mijë euro hiqni krejt se, nuk jeni duke i shpezu kurrë, prandaj mos i lypni, mos lypni kur nuk shpenzoni po ju mbesin gjithë, luftoni për mi marr këtë pjesën 80 mija apo sa e kishe mirë, mos e lypni kur s'e shpenzoni kufizoni bëni plan të shpenzueshëm, por, lype vetëm këtë që e kemi aprovuar janë kode edhe unë mendoj që të gjithë ne si anëtarë të KQZ-ës duhet ta bëjmë një ndikim që ajo le të përmbushet le të rritet ajo pjesë tek e fundit ne e kemi aprovuar këto kode, një vendim i Gjykatës Kushtetuese që ekziston për atë punë që duhet mu barazu edhe mu luftu mu realizu për punëtorët e KQZ-ës. Tash përndryshe pjesa tjetër si planifikim më duket që është ok në rregull.

Eshref Vishi: Unë po ndërlihdna me atë që e tha kolegu Samiu...Te kategoria e pare, d.m.th., te planifikimet për 2018 - 2019 dhe 2020..., shënojnë një rritje prej 385 mijë euro dhe më tepër që ka të bëjë me pagat e nënpunësve civil. Dihet që niveli i pagave, nuk është një proces krejt i përfunduar dhe i pranuar d.m.th., ne jemi në proces e sipër. Unë, dyshoj se ky planifikim do të miratohet edhe nga ana e Qeverisë dhe do të procedohet pastaj në Kuvend kështu, më duket se ne e kemi lënë pak si anash për kundër që jemi marr me këtë punë...Kemi miratu një rregullore, mirëpo mua më duket i pa realizueshëm praktikisht dhe, nuk mund të startoj Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në vitin 2018 me një nivel tjetër të pagave. Unë, nuk di veq ne duhet ta marrim seriozisht këtë punë që t'i vnojme pikë edhe ta zgjidhim problemin...

Sami Hamiti: Unë mendoj që është i realizueshëm. Çështja e procedimit të buxhetit është në vazhden e diskutimeve parlamentare dhe në Komisionin për Buxhet, po themë që ndikimi i të gjithë anëtarëve tonë

që janë këtu brenda në komision që të pranohet më shumë sepse, është diçka që s'po kërkohet jashtë ligjit por, është çështje edhe e një vendim të Gjykatës Kushtetuese...Mendoj se e aprovon atë dhe anën tjetër, është mirë me pa ndikimin tone, me u realizu një e drejtë...Nuk është vonë se është paraqitë edhe rregullorja, ajo ekziston e pse këta nuk i kanë përmbushë obligimet si sekretariat nuk e di, por duhet me i përmbushë... Unë, e di atë punë se nuk kanë ndërmarr asgjë me ato rregullore por, e di që i kanë është aprovuar dhe ne mund të luftojmë për diçka që është e realizueshme për vitin e ardhshëm...Pra, nuk ka dilemë: nëse ne insistojmë, edhe e kryjm këtë punë...

Eshref Vishi: Unë thash që është një proces i papërfunduar ende, kështu që është mirë që të angazhohemi të gjithë dhe ta jetësojmë këtë nivelim të pagave...

Valdete Daka: Jo, fokusi është te shpenzimet kapitale d.m.th., shpenzimet kapitale asnjëherë nuk po shpenzohen...!

Sami Hamiti: Apsolutisht, unë i aprovoj ato projekte janë shumë të mira por, definoni ato që s'i kryni që po ju mbesin e mos i lypni ato projekte që s'mund t'i realizoni se nuk është në rregull...Kaq, mos lypni diçka që s'mundeni me realizue, lypni konkret...

Adnan Rrustemi: Unë, në fakt për këtë çështje kisha nevoja për sqarime shtesë. E para, duke qenë se po dalim nga dy palë zgjedhje kam prit më shumë ide për projektë vitin e ardhshëm për mi përmirësu ose për mi adresu disa prej mësimëve të nxëna d.m.th., krejt çka po shoh është një projekt për informim të votuesve se si plotësohen fletëvotimet. Nuk jamë i sigurtë që është projekt adekuat por, nuk e di se si e arsyetojnë dhe se si e mnedojnë me e realizue githmonë duke e parasysht që duhet m'u realizue në atë mënyrë që nuk i adresohet zgjedhjeve konkrete por, njëfarë edukimi: jashtë mënyrave konvencionale që kemi përdorur deri më tani. Për këtë projektin "Vendbanimi im vendvotimi im", unë jamë dakord, se është i domosdoshmë madje, është si me thënë një lloj bartje e vazhdueshme nga viti në vit, i cili edhe nuk po realizohet për shkak të proceseve zgjedhore që po i kemi...E di që duhet ta kemi parasysht këtë fakt por, lista votuese mendoj që duhet me pas më shumë hapsirë... Nuk është as ky projekt me 30 mijë euro, nëse e kam të qartë që i adreson problemet që i ka lista e votuesve...

Për këtë punënë e trajnimeve që tash është 50 mijë, pra 2 herë më shumë se lista e votuesve, nuk e di a la vlenë, nuke di se për çfarë trajnime është fjala...Trajnime të kujt...? Tash nuk e kam të qartë: 84 mijëshi që në një farë mënyre është brenda kufijve se si shpërndahet në kuadër të projekteve të planifikuar...Paraprakisht: A po konsiderohet që është jashta kufive...? A ka mundësi me u gjetë në ndërkohë, ose m'u bë transferime...? Unë nuk po kuptoj në këtë aspekt... Tash nëse i kemi 84 mijë brenda kufive, a nënkupton kjo që vetëm këto i kemi në dispozicion dhe ku shkojnë tash këto 84 mijë euro në kuadër të këtyre 4 projektëve...? Cili bjen cili s'bjen, cili reduktohet e cili jo...? Unë, se kam të qartë këtë...

Ilir Gashi: Për sa u përket projekteve.... Faktikisht, edhe nuk e di saktë, për shembull ky sistemi këtu me sa e di unë, jemi të varur prej serverve të qeverisë...! A ka mundësi ne më ba të pavarur serverin në mënyrë që të mos dështojmë sepse mire është kur e realizojmë një projekt të madh se krejt puna jonë e mirë që shtë bërë gati gjatë zgjedhjeve, ka marr nota negative në mbrëmje. Kështu që është mirë me ideue një projekt të këtillë, qoftë edhe duke i anashkaluar disa të tjerë dhe, me kërkuar bugjet se besoj

që për projekte të këtilla, bugjetin mund ta sigurojmë pa problem në mënyrë që të pavarsohemi në këtë sistem të teknologjisë edhe të mos kemi defekte të cilat na u shfaqën pas mbylljes e vendotimeve...

Adana Rrustemi: Kur do që ta analizojmë procesin zgjedhor si të 11 qeshorit si të 22 tetorit në mësimet e nxëna kemi me pa se sa nevoja ka me dal për aktivitete që e përmirsojnë procesin e përmirsojnë sistemin kur ti shohim edhe rekomandimet e vëzhguesve vendor e ndërkombëtar. Kështu që po shpresoj që të paktën në 2019 do ta kemi vitë jo zgjedhor që do të adresohen shumë prej qështjeve por, lista e votuesve me 30 mijë euro është jo serioze për mi dhënë rëndësi këtë le ta kemi të qartë. Ju, mundeni mos me pas as ide as si me thënë është jashta mundësive tona edhe ligjore veqse po e dimë qdo ditë e më tepër që po mbete një nga problemet kryesore sikurse që pajtona me punën e rezultateve, duhet me mendu për një ide tjetër të raportimit të rezultateve, mënyra qysh po silllet ose qysh po funksion nuk e di detajet kompania që po e kontraktujmë është përtej jo seriozitetit, unë nuk e di qfarë masa keni me marr për sjelljet me 22 tetor por ne nuk mujm më më mbet kështu të varur komplet.

Sami Hamiti: Unë, po d'u edhe një element me shpjegue, faqen e fundit hiqne, s'jeni t'u ja qëllue kërkund, s'ka bugjet të përgjithshëm gjinorë por, ka bugjet të përgjegjshëm gjinor...S'ka të bëjë me paga, s'ka të bëjë me numra. Pa modesti po e them: unë jam goxha njohës i kësaj lëmie, sidomos i kësaj pjesës që është fazë shumë e re, është bugjet i përgjegjshëm gjinor...

Valdete Daka: Edhe një pyetje, prap se morëm përgjigjen...Kjo "informimi dhe edukimi i votuesve", ky bugjeti prej 80 mijë euro...ne s'morëm përgjigje për te...?

Adnan Rrustemi: Këtu, tash janë 80 mië euro dhe unë nuk ke di në këto 4 projektet çka ndahet, a çka reduktohen, a heqet ndonjë projekt...? Unë, nuk jamë për m'i heqë, por a ka amundësi m'i reduktue se për shembull, trajnimi prej 50 mijë euro është shumë i shtrenjtë, nuk po e di se për çfarë trajnimi është fjala...? Automatikisht, mundet me ra në 20 mijë euro...

Valdete Daka: Asnjëherë nuk janë harxhuar 50 mijë euro për trajnime...

Enis Halimi: Ne kemi menduar em angazhuar ekspertë të huaj...Ju e dini që në vitin 2015/16 kemi zhvilluar trajnime dhe ato janë zhvilluar me financimin e tyre. Nëse kujtoj, kanë qenë 13 module...Ekspertët e jashtëm, kushtojnë shtrenjtë...

Sami Hamiti: A janë trajnuar qysh duhet për 5 vjet punëtorët e sekretariatit...Ndaluni njëherë, zhvillone trajnimin njëherë me 30 mijë euro..e masandej...

Adnan Rrustemi: Kam edhe dy pyetje teknike: Në tabelën 13, në faqen 11 ka tepër shuma në kolonën e planit të bugjetit që nuk kanë përshkrim në kolonën e kategorisë. Unë, nuk e kuptoj për çka janë për shembull 83 mijë euro....?

Sami Hamiti: Jo, k a përshkrim...ka...

Miradije Meha: Ne, po e përfundojmë vitin zgjedhor sivjet me dy parë zgjedhje. Unë e kam shqetësimin tim e kam shpreh edhe te kryeshefi sa i përket pagesave të KVV-ve nëse vazhdohet me këtë trend neve

kan me na u bart obligimet për vitim 2018. Nuk e di se si do të veprojmë...! Zgjedhjet i kemi pas në Drenas, atëherë komplet rundi i dytë na ka mbetë KVV-të pa i paguar...

Sami Hamiti: Duhet me shkuar te ministri dhe me kërkue shtyrjen e pagesave...

Miradije Meha: Pagesën nuk është problemin e rregulloj me një shkresë pa u involvuar ju hiq i drejtohem...se, këtë e parasheh edhe ligji. Po, çka nëse mbesin për vitin 2018...?

Ilir Gashi: Ne me të 19 e kryjmë me ministrinë, por ju duhet me i thirrë KKZ-të dh me ju treguar se çfarë dokumentacioni duhet me pranuar ata për të gjithë të punësuar aty. Le t'i ambajnë ata pastaj përgjegjësinë e tyre nëse, për shembull ata i bijnë kartela e dikujt tjetër ose dokumentet e tjera. Kur ju t'i siguron këto, ma s'keni me pas problem...

Merrni masa preventive me kohë...dhe pastaj ma nuk do të keni problem...

Anëtarët e KQZ-së, miratuan edhe këtë rekomandim të KB-së

Valdete Daka: Edhe një pyetje: A ka mundësi QNR-ja sot me i përfunduar numërimet...?

Enis Halimi: Unë, pa ardhë në mbledhje bisedova me Burimin...! Nuk mund të bëj një projeksion të saktë se, a do të mundemi ne sot pas dite me i shpallë rezultatet apo jo...

Valdete Daka: Janë edhe dy kuti, a ta marrim sot një vendim...? Na duhet një vendim...

Binak Vishaj: Pa ardhë Burimi këtu, nuk mundemi...

Sami Hamiti: Sot, meqë i kemi edhe dy kuti nuk mundemi me i shpallë, jo sot nuk ka shanse...Për ato dy kuti, konfirmojani Burimit vendimin tonë...

Për KQZ

Valdete Daka, kryetare
